



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201400992/9

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandojmë ndërhyrjen Tuaj për zgjidhjen e çështjes së miratimit sa më të shpejtë të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar në Komunën Shalë, Dukagjin.*

**Drejtuar :** **Z. Saimir TAHIRI**  
**Ministër i Punëve të Brendshme**

**TIRANË**

**Z. Erjon VELIAJ**  
**Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë**

**TIRANË**

**Z. Bledi ÇUÇI**  
**Ministër Shteti për Çështjet Vendore**

**TIRANË**

***Të nderuar zotërinj ministra,***

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.V, banues në Komunën Shalë, Dukagjin, me objekt: mosdhënien e së drejtës për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar që nga muaji Janar 2014.

Sipas shpjegimeve të tij, është invalid tetraplegjik, grupi i parë dhe është përfitues i të drejtave ligjore që rrjedhin nga gëzimi i Statusit të Invalidit Paraplegjik-Tetraplegjik. Nuk ka përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar që nga muaji Janar 2014 dhe kjo ka krijuar barriera, duke mos përballuar dot nevojat me imediate të jetesës së përditshme, pasi ajo pagesë është e vetmja e ardhur e tij.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike,

si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, vendosi pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankesë, kërkuam shpjegime pranë Kryetarit të Komunës Shalë, Dukagjin, mbi arsyet e mosdhënies së pagesës së aftësisë së kufizuar që nga muaji Janar 2014.

Në përgjigje të kërkesës sonë, u informuam se Këshilli i Komunës Shalë nuk mbledhet për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të përcaktuara ligjore që nga data 24.06.2013. Për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2013, me ndërhyrjen e Prefektit të Qarkut dhe Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, u arrit konsensusi për miratimin e ndihmës ekonomike dhe pageses së aftësisë së kufizuar.

Për vitin 2014, çdo muaj është bërë kërkesë nga Kryetari i Komunës Shalë për mbledhjen e Këshillit për miratimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar si edhe për çështje të tjera në shërbim të komunitetit, por nuk ka patur asnjë reagim pozitiv. Edhe mbledhja e datës 29.04.2014 nuk u arrit të realizohej, pasi mungonin 8 këshilltarët e Komunës Shalë.

Pra, siç konstatohet nga ky informacion i marrë, mosdhënia e pagesës së aftësisë së kufizuar, ka ardhur si rezultat i mosfunksionimit të Këshillit të Komunës Shalë.

Ky qëndrim i mbajtur nga ana e Këshillit të Komunës, konsiderohet si një veprim, i cili vjen në kundërshtim të hapur me ligjin, pasi bazuar në Ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për Ndhimën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore", i ndryshuar, në nenin 20, pika 1, thuhet shprehimisht se:

*"Ndhima ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar, shpërndahen një herë në muaj me vendim të këshillit të qeverisjes vendore".*

Me qëllim që personat me aftësi të kufizuar të përfitojnë të drejtat e tyre ligjore, iu drejtua me rekomandim Prefektit të Qarkut Shkodër për marrjen e menjëhershme të masave për dhënien e pagesës së aftësisë së kufizuar përfituesve të Komunës Shalë Dukagjin.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, ndër të tjera, u informuam se Prefekti i Qarkut Shkodër kishte njoftuar një mbledhje të posaçme me Këshillin e Komunës Shalë më datë 07.07.2014, me rend dite: "Miratim i ndihmës ekonomike dhe paaftësisë për komunitetin e komunës Shalë për periudhën Janar-Qershor 2014."

Pas marrjes së kësaj përgjigjeje, iu drejtua përsëri Prefektit të Qarkut Shkodër, nëse ishte realizuar kjo mbledhje.

Me shkresën nr. 1349/1 datë 04.08.2014, një kopje të së cilës po jua dërgojmë bashkangjitur, rezulton se ende nuk është zgjidhur ky problem, pasi këshilltarët nuk kanë konsensus dhe nuk dëshirojnë të miratojnë minimumin jetik për banorët nga të cilët janë zgjedhur, duke penalizuar të gjithë komunitetin e asaj zone. Në këto kushte, Prefekti i Qarkut Shkodër i ka kërkuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore, miratimin e një akti normativ për shpërndarjen e ndihmës ekonomike nga zyrat vendore të njësisë në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit Social Shtetëror.

Pavarësisht arsyeve të vonesave për përfitimet e përcaktuara ligjore, Avokati i Popullit gjykon se nuk duhet të ketë pengesa për t'u bërë shkak i cënimit të të

drejtave ligjore të personave në nevojë që pretendojnë apo trajtohen me ndihmë ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 52, pika 2, ka përcaktuar se: *“Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavaruar nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës ekonomike në kushtet e parashikuara me ligj”.*

Ndërsa në nenin 59, pika 1/ “e” dhe “f”, ka përcaktuar si objektiva sociale të shtetit, edhe :

*e. përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët,*

*f. riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.*

Për sa më sipër, me qëllim përfitimin e të drejtave ligjore në përmbushje të objektivave socialë, realizimi i të cilave është i lidhur ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të bërë të mundur garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe të pikës 3 të nenit 7 të Ligjit nr. 8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin ”, ku thuhet shprehimisht se: *“Këshilli i Ministrave, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore dërgojnë rregullisht te prefekti të gjitha aktet që ata nxjerrin, të cilat, në përmbajtje të tyre, caktojnë detyra në fushën e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor ose detyra për organet e administratës së qeverisjes vendore”*,

## **REKOMANDOJMË:**

*Ndërhyrjen Tuaj për zgjidhjen e çështjes së miratimit sa më të shpejtë të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar në Komunën Shalë, Dukagjin.*

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

**Me respekt**

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

